



Bazuar në nenin 38 të Ligjit mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Paneli i Bordit të Bankës Qendrore (BQK) publikon:

### Shpallje

Për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështje juridike;
- Njohuri në zhvillimin dhe implementimin e politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Përvojë dhe aftësi menaxheriale;
- Të përmbushë kërkesat nga neni 40 i Ligjit mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar më 27 mars 2018 ose në datën e emërimit. Nëse personi i emëruar nuk është anëtar ekzistues i Bordit të BQK-së, i njëjti ka të drejtë të riemërohet për një mandat tjetër pesëvjeçar.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës i cili do të përzgjedhë një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84.27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38.2 të Ligjit të BQK-së.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ose në dorë në kovertë të mbyllur në Arkivin e BQK-së, ndërtesa e BQK-së, Rruga Garibaldi nr.33 në Prishtinë ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ( Shënim: për pozitën e Guvernatorit), Rruga Garibaldi nr. 33, 10000, Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 29 nëntor 2017, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e Panelit do të thirren për intervistë.